

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 13.09.2022, në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 58/2006...96/2019) dhe nenit 63 paragrafi (1) nga Rregullorja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 14/2022), duke vendosur mbi iniciativën për miratimin e qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor, të parashtruar nga Snezhana Stankoviq, avokate nga S., nxori këtë:

## K O N K L U Z I O N

Iniciativa mbi miratimin e qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor, Su-03.nr.353/22, të parashtruar nga Snezhana Stankoviq, avokate nga S., NUK APROVOHET.

## A r s y e t i m

Sipas nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.58/06 ... nr.96/19), Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 13.09.2022 diskutoi mbi iniciativën për miratimin e qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor, të parashtruar nga Snezhana Stankoviq, avokate nga S., Su-03.nr.353/22 të datës 03.06.2022, mbi çështjen me kuptim për sigurimin e barazisë me zbatimin e ligjeve nga gjykatat, më saktë lidhur me dispozitat e nenit 5 paragrafi (9) nga Tarifa për shpërblim dhe kompensim të shpenzimeve tjera për punën e përmbaruesve (“Gazeta Zyrtare e RMV” nr.32/2019 të datës 07.02.2019). Sipas parashtrueses, ekziston qëndrim i ndryshëm sa i përket interpretimit të dispozitës së theksuar në praktikën gjyqësore.

Propozuesi thërritet në aktgjykime konkrete të Gjykatës Themelore Civile, PL1-TS-1529/21, PL1-TS numër 687/19 të datës 8.11.2019 e konfirmuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Shkup TSH-197/20 të datës 23.12.2020 dhe PL1-TS-221/21 të datës 31.05.2021 të konfirmuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Shkup TSH-1659/21 të datës 02.12.2021, ku është shprehur qëndrim se paditësi – përmbaruesi nuk ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve nga kreditori, ngase procedura është ndërprerë për shkak të vdekjes së debitorit, e njëjta nuk ka përfunduar, përkatësisht në mes palëve është bërë marrëveshja për shtyrjen e pagimit të shpenzimeve përmbaruese, duke qenë se procedura ka filluar pa pagimin e shpenzimeve administrative, referon në konkluzionin se paditësi ka pranuar që shpenzimet t’i paguajë nga debitori pas realizimit të dokumentit përmbarues.

Si praktikë gjyqësore në të cilën është shprehur qëndrim më ndryshe, propozuesi dorëzon aktvendimet të Kryetarit të Gjykatës Themelore Manastir, PPNI-115/20 të datës 26.10.2020 dhe PPNI-134/20 të datës 30.09.2020, si dhe aktvendimet e Gjykatës së Apelit Manastir GZH-1270 të datës 21.10.2020, GZH-1269 të datës 21.10.2020 dhe GZH-1267/20 të datës 21.10.2020 ku kundërshtimi i debitorit refuzohet, ndërsa veprimi përmbarues që përbëhet nga nxjerrja e Konkluzionit për përcaktimin e shpenzimeve mbetet në fuqi, në mënyrë që gjykata ka konstatuar se përmbaruesi ka të drejtë të kërkojë nga kreditori që t’i paguajë kompensim për përpunimin e lëndës, çmimin e veprimeve përmbaruese, shpërblimin e përmbaruesit për veprimet përmbaruese, shpenzimet reale dhe taksat, pa dallim se në cilën fazë gjendet përmbarimi, ndërsa pas zbatimit të përmbarimit të gjitha këto shpenzime përmbaruesi i paguan nga debitori dhe ia bart kreditorit.

Nga praktika gjyqësore e dorëzuar nga propozuesi, aktgjykimet e Gjykatës së Apelit me të cilat konfirmohen aktgjykimet e Gjykatës Themelore Civile Shkup, mund të konstatohet se gjykatat në vendimet e dorëzuara, absolutisht nuk thërriten në dispozitën e nenit 5 paragrafi (9) nga Tarifa për shpërblim dhe kompensim të shpenzimeve tjera për punën e përmbauesve ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.32/2019 të datës 07.02.2019), në bazë të së cilës propozuesi e parashtron iniciativën dhe për të cilën pretendon se ekziston interpretim ndryshe. Në fakt, aktgjykimet e theksuara janë miratuar në bazë të Tarifës për shpërblim dhe kompensim të shpenzimeve tjera për punën e përmbauesve ("Gazeta Zyrtare e RM" numër 9/11 të datës 25.01.2011), që ka qenë në zbatimin e kohës së miratimit të këtyre vendimeve edhe atë, neni 3 paragrafi (6) në të cilën është shënuar se çmimin e administrimit përmbauesi e paguan nga kreditori para se të fillojë me veprimet përmbauese, në të kundërtën (në qoftë se kreditori nuk e paguan çmimin e administrimit para fillimit të veprimeve përmbauese), përmbauesi ka të drejtë që t'ia kthejë kërkesën për përmbauesim. Duke u nisur nga dispozita e cituar, në vendimet e Gjykatës së Apelit Shkup, gjykatat kanë shprehur qëndrim se paditësi-përmbauesi ka pranuar që t'i paguajë nga debitori pas realizimit të dokumentit përmbaues duke qenë se i padituri-kreditori nuk e ka paguar çmimin për administrimin e lëndës, ndërsa përmbauesi nuk ia ka kthyer kërkesën për përmbauesim por ka filluar me ndërmarrjen e veprimeve.

Duke u nisur nga e theksuara, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, konsideron se nuk mund të konstatohet se ekziston qëndrim ndryshe lidhur me interpretimin e dispozitës së nenit 5 paragrafi (9) nga Tarifa për shpërblim dhe kompensim të shpenzimeve tjera për punën e përmbauesve ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.32/2019 të datës 07.02.2019), ndërsa duke qenë se në praktikën e treguar gjyqësore, në aktgjykimet e Gjykatës së Apelit Shkup, absolutisht nuk është zbatuar dispozita e theksuar, por janë zbatuar dispozitat nga Tarifa e vlefshme më parë, e cila ka vlejtur në kohën e vendimmarrjes, ndërsa në bazë të së cilave janë miratuar vendimet e sipër theksuara.

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke u nisur nga e sipër konstatuara, erdhi në konkluzion se nuk janë të plotësuara kushtet për miratimin e qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor për çështjen me kuptim të sigurimit të barazisë me zbatimin e ligjeve nga gjykatat, në kuptim të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat, ndërsa për çështjen e parashtruar juridike me iniciativën e parashtruar, në mënyrë që vendosi si në kumtimin e këtij Konkluzioni.

Gjykata Supreme e  
Republikës së Maqedonisë së Veriut  
Seanca e përgjithshme